**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA DIBËR**
**KËSHILLI BASHKIAK DIBËR**

Nr. 2217 Prot                                                    Peshkopi, më 21.06.2022

**Lënda:** Dërgim vendimi

**Drejtuar:** Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër **Nr.53 Datë 16.06.2022**

**"Për miratimin e një punonjësi Social/Lehtësues për shërbimet për të rinjtë dhe familjen"."**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**Në mungesë dhe porosi**

Punonjësja e Sekretariatit të Këshillit

**P/ Sara Karaj**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DIBËR

BASHKIA PESHKOPI
Nr. 2217 Prot.
Mbërritur 23/06/2

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**PREFEKTI I QARKUT DIBËR**

Nr.580/1.prot.

Peshkopi, më 23.06.2022

Lënda : Per vendimin nr. 53, datë 16.06.2022 të Këshillit të Bashkisë Dibër

Drejtuar : BASHKISE DIBER

PESHKOPI

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, date 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e Këshillit të Bashkisë Dibër nr.53, date 16.06.2022 "Për miratimin e një punonjësi social/lehtësues për të rinjtë dhe familjen", konstatova se:

Akti administrativ objekt verifikimi dhe shqyrtimi bën pjesë në kategorinë e akteve me karakter individual për pasojë nuk është në kompetence të Prefektit të shprehet për ligjshmërinë e këtij vendimi. .

Hyrja në fuqi e akteve administrative të karakterit individual bëhet sipas parashikimit të paragrafit të fundit të nenit 55/6 të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", nën përgjegjësinë direkte administrativo-ligjore të strukturave të posaçme të Bashkisë Dibër.

PREFEKTI

Nexhbedin SHEHU

*Adresa : Bulevardi "Elez ISUFI" Peshkopi, Albania, Tel. 00355 218 2- 2082,Tel 00355 218 2– 2631, E-mail prefekturadiber@gmail.com*

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA DIBËR**
**KËSHILLI BASHKIAK DIBËR**

**VENDIM**

**Nr.53 Datë 16/06/2022**

**"Për miratimin e një punonjësi Social/Lehtësues për shërbimet për të rinjtë dhe familjen"**

Në mbështetje të ligjit nr.139/205 "Për vetëqeverisjen vendore", duke u mbështetur në ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.64 datë 24.12.2021 "Për miratimin e Numrit të Punonjësve të Administratës të Bashkisë Dibër, Institucionevë në varësi dhe Njësive Administrative për vitin 2022", vendimin e Këshilli Bashkiak Dibër nr.01 datë 13.01.2022, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin nr.54/1 prot. datë 21.01.2022 "Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Dibër" Marrëveshje standarte nëngranti midis Bashkisë Dibër dhe Zyrës Kombëtare Save the Children në Shqipëri, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 16.06.2022 me 18 vota pro,2 kundër dhe 0 apstenim

**VENDOSI:**

1. Miratimin e një punonjësi Social/Lehtësues për shërbimet për të rinjtë dhe familjen bazuar në "Marrëveshjen Standarte nëngranti midis Bashkisë Dibër dhe Zyrës Kombëtare Save the Children në Shqipëri".
2. Përfshirjen e një punonjësi si pjesë e Strukturës së Bashkisë Dibër.
3. Kjo marrëveshje fillon nga data 01.07.2022 dhe përfundon 31.12.2024.
4. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Sektori i Financës pranë Bashkisë Dibër.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

**Kryetar Këshilli**
**Sokol Sava**

-REPUBLIKA E SHQIPËRISË- BASHKIA DIBËR

Adresa: Bulevardi "Elez Isufi" Peshkopi, email: bashkiadiber@gmail.com tel:0035521822937

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**BASHKIA DIBËR**

**DREJTORIA E SHERBIMEVE MBESHTETESE**

**PROJEKT-VENDIM**

**Nr. 04 Date 15/06/2022**

**"Për miratimin e një punonjësi Social/Lehtësues për shërbimet për të rinjtë dhe familjen"**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.64, datë 24.12.2021 "*Për Miratimin e Numrit të punonjësve të Administratës së Bashkisë Dibër, Institucioneve në varësi dhe Njësive Administrative përvitin 2022* vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.01 datë 13.01.2022, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin , nr.54/1 prot. datë 21.01.2022.Për miratimin e Buxhetit te Bashkisë Dibër" Marrëveshje standarte nengranti midis Bashkisë Dibër dhe Zyrës Kombetare Save the Children në Shqipëri.

**<u>Kërkojmë:</u>**

1. Miratimin e një punonjësi Social/ Lehtësues për shërbimet për të rinjtë dhe familjen" bazuar Marrëveshjen standarte nëngranti midis Bashkisë Dibër dhe Zyrës Kombetare Save the Children në Shqipëri.
2. Përfshirjen e 1 (një) punonjësi si pjesë e Strukturës së Bashkisë Dibër.
3. Kjo marrëveshje fillon nga data 01.07.2022 dhe përfundon më 31.12.2024 .
4. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Sektori i Financës pranë Bashkisë Dibër.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak Dibër dhe shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

Adresa: Bulevardi "ELEZ ISUFI", Peshkopi, email:bashkiadiber@gmail.com nr.tel:0035521822935

**PËR BASHKINË DIBËR:**

Përgjegjëse e Burimeve Njerëzore

Malbora Lala

Pergjegjëse e Sektorit Juridik

Elona Lusha

Drejtori Ekonomik

Lorenc Cibaku

**KRYETARI I BASHKISË**

**Rahim SPAHIU**

Adresa: Bulevardi "ELEZ ISUFI", Peshkopi, email:bashkiadiber@gmail.com nr.tel:0035521822935

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**BASHKIA DIBËR**

**DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

**RELACION**

**{Me të dhëna të grupuara "Për miratimin e një punonjësi Social/ Lehtësues për shërbimet për të rinjtë dhe familjen" bazuar Marrëveshjen standarte nëngranti midis Bashkisë Dibër dhe Zyrës Kombetare Save the Children në Shqipëri}**

**KËSHILLIT TË BASHKISË DIBËR**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 54, *"Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak"* pika "dh", citohet " *miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij. Në vendimin për miratimin e buxhetit miraton, gjithashtu, edhe numrin e maksimal të punonjësve të bashkisë, si dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë*; duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.64, datë 24.12.2021 *"Për Miratimin e Numrit të punonjësve të Administratës së Bashkisë Dibër; Institucioneve në varësi dhe Njësive Administrative përvitin 2022* vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.01 datë 13.01.2022, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin , nr.54/1 prot. datë 21.01.2022."Për miratimin e Buxhetit te Bashkisë Dibër"

Kërkojme nga ana juaj miratimin e këtij projekt-propozimi për miratimin e 1 (një) punonjësi Social/ Lehtësues për shërbimet për të rinjtë dhe familjen" bazuar Marrëveshjen standarte nëngranti midis Bashkisë Dibër dhe Zyrës Kombetare Save the Children në Shqipëri}

Qendra e Shërbimeve Sociale për të rinjtë dhe familjen, në Peshkopi është një institucion që ofron shërbime psiko-sociale për adoleshentët, të rinjtë dhe familjet në nevojë me qëllim mirëqënien, fuqizimin dhe qëndrueshmërinë nga pikëpamja sociale dhe ekonomike.

Qendra është në varësi të Sektorit të Kujdesit Social të Bashkisë Dibër. Përshkrimi i punës ofron strukturën përmbajtësore të shërbimeve, rolit dhe përgjegjësive dhe angazhimin e punonjësit Social /Lehtësues. Punonjësi Social do të bashkëpunonjë me drejtuesit dhe anëtarët e stafit të Sektorit të Kujdesit Social për arritjen e misionit të Qëndrës.

Adresa: Bulevardi "ELEZ ISUFI", Peshkopi, email:bashkiadiber@gmail.com nr.tel:0035521822935

Objektivi i Punonjësit Social/Lehtësues është ofrimi I shërbimit Psikosocial të integruar, efektiv, gjithëpërfshirës duke u bazur në nevojat specifike sociale dhe ekonomike te te rinjve, familjeve dhe komunitetit në respekt të të drejtave të njeriut, barazisë gjinore dhe standarteve kombëtare të sherbimeve në qëndrat komunitare.

Kjo marrëveshje fillon nga data 01.07.2022 dhe përfundon më 31.12.2024 .

Me qëllim rritjen e efikasitetit dhe vazhdimi e ofrimit të shërbimit për të rinjtë adoleshentët dhe familjet në nevojë kërkojme nga ana juaj miratimin e Projek-Vendimit

Duke shpresuar në mirëkuptimin e anëtarëve të Këshillit Bashkiak për miratimin e 1 (një) punonjësi Social/ Lehtësues për shërbimet për të rinjtë dhe familjen" bazuar Marrëveshjen standarte nëngranti midis Bashkisë Dibër dhe Zyrës Kombetare Save the Children në Shqipëri}dhe përfshirjen e tyre si pjesë e Strukturës së Bashkisë Dibër.

**Përgjegjëse e Burimeve Njerëzore**

**Malbora LALA**